

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"ENIM MARINE" SH.P.K.**

Sot, më datë 23/06/2023

Z.Shkelzen Vrioni i datelindjes 04/05/1976, lindur ne Durres dhe banues ne Durres, me zotesi te plote per te vepruar, i pajisur me Karte identiteti me ID 036469633 dhe Nr.personal H60504053P.

Henkel Kuqo i datelindjes 21/01/1981, lindur ne Pogradec dhe banues ne Durres, me zotesi te plote per te vepruar, i pajisur me Pasaporte Nr.BC3562289 dhe Nr.personal I10121023R.

Ka përpiluar këtë Akt Themelimi të shoqërisë tregtare "ENIM MARINE" SH.P.K., me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

Shoqëria Tregtare "ENIM MARINE" SH.P.K., themelohet në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", (këtu e më poshte Shoqëria).

Shoqëria është një person juridik Shqiptar.

**NENI 2**

**Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin "ENIM MARINE" SH.P.K. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

**NENI 3**

**Objekti i veprimtarisë**

Veprimtaria e shoqërisë është:

Prodhime dhe riparime pjesësh të ndryshme plastike me material të përbërë për mjete lundruese, automjete, pjesë industriale, montim dhe prodhim i varkave turistike si dhe mjeteve të tjera të lundrimit, pjesëve dhe aksesoreve të çatave, këndeve të lojrave, kioskave të lëvizshme dhe rulotave, etj. Transport mallrash dhe udhëtarësh si dhe shërbimeve për vete dhe për të tretët brenda dhe jashtë vendit. Pjesëmarrje në shoqëri të tjera me objekt veprimtarie të ngjashme.



Krijimin e agjensive doganore, detare, turistike, etj. Regjim i përpunimit aktiv në fushën e produkteve plastike

Për realizimin e qëllimit të saj shoqëria mund të bashkëpunojë me çdo person fizik apo juridik në çdo mënyrë që e gjykon të dobishme.

Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çdo lloj aktiviteti të parashikuar nga ligji në përputhje me rregullat e dispozitat në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në bazë të autorizimeve dhe/ose lejeve përkatëse të leshuara nga organet kompetente të fushës.

#### **NENI 4**

##### **Selia e Shoqërisë**

Shoqëria ka selinë ligjore: Durres, Vrrinë Shenavlash, Zona Kadastrale, 3339, Godinë me Nr.pasurie 1/28.

#### **NENI 5**

##### **Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie në lekë. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 Lekë dhe përbëhet nga 2 (dy) kuota.

- 1) **Z.Shkelzen Vroni** është zoterues i 1 kuote me 50% pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë në vlerën 50.000 leke.
- 2) **Z.Henkel Kuqo** është zoterues i 1 kuote me 50% pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë në vlerën 50.000 leke.

#### **NENI 6**

##### **Kohëzgjatja e shoqërisë**

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë është i papërcaktuar dhe fillon me regjistrimin e saj në QKB.

#### **NENI 7**

##### **Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asamblea e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratorët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Organizimi dhe funksionimi i këtyre organeve është përcaktuar në statutin e shoqërisë. Shoqëria administrohet nga një Administrator, i cili do të zgjidhet për një afat 5 vjeçar, me të drejtë



riemerimi. Administratori i Shoqërisë do të jetë **Z. Shkelzen Vrioni** i datelindjes 04.05.1976 pajisur me Karte identiteti me Nr.personal H60504053P

Shoqëria perfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori, i cili do të ushtrojë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

#### **NENI 8**

Ortaku themelues mund të vendosi me vullnetin e tij, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

#### **NENI 9**

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

#### **NENI 10**

Ortaku detyrohet të ruajë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

#### **NENI 11**

**Legjislacioni i aplikuar**

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i firmosur nga ortaket e Shoqërisë. Cdo gjë që nuk është parashikuar në Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe nga dispozita ligjore në fuqi.

### **ORTAKU THEMELUES**

**Shkelzen VRIONI**



**Henkel KUQO**

